



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 119..... Prot.

Vlorë, më 11/04/2025

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

• **Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse**

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të gjashtë akteve administrativ – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :

- Nr.29, me Nr.796/1 Prot., datë 12/03/2025, i materializuar për subjektin “Stela Kabello” p.f me NID I76130070W, me banim në Vlorë.
- Nr.35, me Nr.715/2 Prot., datë 18/03/2025, i materializuar për subjektin “VICTOR” sh.p.k me NUIS M26518202V, me seli në Vlorë.
- Nr.36, me Nr.719/2 Prot., datë 18/03/2025, i materializuar për subjektin “ROTONEXT” sh.p.k me NUIS M26901203C, me seli në Vlorë.
- Nr.37, me Nr.720/2 Prot., datë 18/03/2025, i materializuar për subjektin “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë.
- Nr.38, me Nr.808/2 Prot., datë 25/03/2025, i materializuar për subjektin “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë.
- Nr.44, me Nr.908/2 Prot., datë 03/04/2025, i materializuar për subjektin “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, me seli në Vlorë.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të gjashtë akteve të lartcituara - gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) fletë.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të gjashtë akteve të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.796/1 Prot.

Vlorë, më 12/03/2025

V E N D I M N r . 2 9

Sot, më datë 12/03/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, i mbajtur në ngarkim të subjektit “Stela Kabello” p.f me NID I76130070W, me banim në Vlorë (Njësia Administrative Nr.5, Rruga “Ymer Veshi”, ndërtesa nr.12, hyrja 1 kodë postar 9401), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të konstatimit me nr.796 Prot., datë 11/03/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, me lëndë “Dërgohet “Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë”, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr.1666/7, datë 24/01/2025.

Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, u hartua “Plani i Punës” me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në kontrollin dhe verifikimin e deklaratës doganore IM.4 R 5036, datë 12.04.2023, me të cilën nga ana e subjektit “Stela Kabello” p.f me NID I76130070W, e përfaqësuar nga Agjensia Doganore “Gad.Universi” me kod J 102, është deklaruar malli “Motoçikletë – Yamaha SJ18 B 07 XP560D, vitprodhimi 2022; cilindrata 562 cm³; lloji i karburantit benzinë” deklaruar në kodin tarifar *87114000*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tregtar bashkëngjitur praktikës doganore në sistemin Asycuda World, konstatohet se kjo deklaratë doganore nuk përmbush kushtet për vlerësim sipas metodës së transaksionit.

Rezulton se në vlerësimin doganor nuk është ndërhyrë me vlerën 10.550 euro x 80% sipas të dhënave në Due Ruote Aprile 2022, dhe po i njëjti rivlerësim është kryer dhe në deklaratën doganore R 5859 datë 27.04.2023, sipas metodës 6 të vlerësimit. kjo verifikuar në sistemin oracle.

Për këto arsye, pas marrjes në shqyrtim të rekomandimit të lartpërmendur, nga ana e grupit të kontrollit, është mbajtur Proces – Verbal i konstatimit nr.796 Prot., datë 11/03/2025.

Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ka proceduar me shkresën Nr.3826 Prot., datë 30/12/2024 me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën ka njoftuar subjektin për fillimin e procedurës administrative.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III “Vlera për qëllime doganore” neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave, V.K.M-në nr.651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Stela Kabello” p.f me NID I76130070W, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **152,258** (njëqind e pesëdhjet e dy mijë e dyqind e pesëdhjet e tetë) lekë, për deklaratën doganore IMP- 4 me numër R 5036, datë 12/04/2023.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Stela Kabello” p.f me NID I76130070W, i lejohej të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.715/2 Prot.

Vlorë, më 18/03/2025

V E N D I M N r . 3 5

Sot, më datë 18/03/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “VICTOR” sh.p.k me NUIS M26518202V, me seli në Vlorë (Lagjja “Kushtrimi”, Rruga “Odhise Kasneci, pranë ish përpunim Druri, magazinë nr. 7), me administrator znj. Mariarosaria Ratta, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0025380, nr.715 Prot., datë 06/03/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, protokolluar me Tonën me nr.1666/7, datë 24/01/2025, me lëndë “*Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë*”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti. Autorizimi i regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë me nr. P20220510/10667/1, i operatorit ekonomik “Victor” shpk, me Nipt M26518202V, rezulton me diferenca përse i përket artikullit me kod tarifor NK 82089000 me emërtimin “Fustela”. Gjatë kontrollit në Sistemin Asycuda (Processing Program and CUO) autorizimi del i mbyllur ndërkohë që operatori ka eksportuar 451 copë “fustela” me tepër se nga sa ka importuar (8,169 copë – 8,620 copë) ose 90 kg me vlerë 2,495 euro, pra operatori ekonomik ka riekportuar më tepër fustela sesa ka importuar.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shqyrtim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0025380, nr.715 Prot., datë 06/03/2025, ku në pjesën përshkuese është parashtruar si vijon : “*Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23/01/2025, rezulton se subjekti “VICTOR” i pajisur me autorizimin e R.L.P me përjashtim të plotë*

Nr.10667/1 dt 10/05/2022, nuk ka mbyllur autorizimin në mënyrën e duhur. Subjekti ka eksportuar 451 copë fustela më tepër se sa ka importuar”. Subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcituar dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Rezulton e provuar se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative të kryer me neglizhencë.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Ndërsa në nenin 257, 1/b kemi : 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “VICTOR” sh.p.k me NUIS M26518202V të penalizohet në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “VICTOR” sh.p.k me NUIS M26518202V, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 719/2 Prot.

Vlorë, më 18/03/2025

VENDIM Nr.36

Sot, më datë 18/03/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “ROTONEXT” sh.p.k me NUIS M26901203C, me seli në Vlorë (Rajoni nr.2, Lagjja "Pavaresia", Rruga “Gjergj Araniti”, Pallati 29, Kati1), me administrator z.Leonard Lako, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032734, nr.719 Prot., datë 06/03/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, protokolluar me Tonën me nr.1666/7, datë 24/01/2025, me lëndë “*Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë*”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Operatori ekonomik “Rotonext” Shpk, me NIPT M26901203C, vepron nën Regjimin e përpunimit aktiv nr. 16495/1 prot., datë 20/12/2020, i autorizuar për prodhimin e “Suport mbajtës i makinës se balancimit të gomave, kapak i pjesës përbërëse të fshesës me korent, karrige për fëmijë”.

Sistemi i autorizuar: me pezullim; Sasia e vlerësuar: 262,510 copë; Vlera e vlerësuar 428,303 euro.

Periudha e vlefshmërisë: 12 muaj; Kufiri kohor për rieksporim: 365 ditë ditë.

Mallrat që do të vendosen nën regjimin doganor janë me kod tarifor si më poshtë ;

3901, 7419, 7228, 7317, 3926

Produktet kompensues të përfituara nga përpunimi i lëndëve të para do të jenë sipas kodeve tarifor si vijon : 3923, 3926

Në fund të periudhës, situata/bilanci material i autorizimit sipas sistemit oracle/ databaze kombëtar paraqitet si më poshtë :

Nr.	Emërtimi	Procedura	P. Neto	VI. Fat.	Tax. Dog
a	Import 5	5100	127,659	337,116	4,846
b	Export 3	5171	107,507	261,650	0
c	Import 9	3151	1,549	1	0
d	Transf. në Aut. 20231226/28021/1 - Dav. R594 dt.,19.01.2024		18,603	75,467	0
e	Totali (a-b-c-d)		0.15	-1.00	4,846.00

Referuar tabelës së mësipërme – bilanci material i autorizimit nuk rezulton i mbyllur për vlerën e taksës doganore në shumën 4,846 lekë.

Në zbatim të nenit 15 titulli IV të Ligjit nr. 9590, dt. 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtarë” sipas të cilit : “pika 3: *Eksportuesi i produkteve mbuluar nga vërtetimi i origjinës duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesë të autoriteteve doganore të gjitha dokumentat e nevojshëm që provojnë se anjë tërheqje nuk është bërë në lidhje me materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet doganore ose detyrimet e tjera me të njëjtin efekt të aplikueshëm në të gjitha materialet aktualisht kanë qenë paguar*”.

Në analizë të deklaratave të eksportit, konstatohet se, të gjitha eksportet janë të pajisur me certifikatë origjine shqiptare, si rrejdhojë, bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Doganor të RSH, në të cilin parashikohet shprehimisht: “Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat joorigjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territoreve ose grup-vendeve ose territoreve të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore të riekportit për këto mallra”, si dhe pikën 14 të Udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të RPA” dhe pikën XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës” të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të RPA”, mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e përpunuara të cilat kanë përfituar origjinë preferenciale shqiptare duhet t’i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale.

Nga operatori ekonomik është konsumuar kundërvajtja administrative e parashikuar nga nenet 250/1/a dhe 252/c të Kodit Doganor dhe duhet të penalizohet në mbështetje të nenit 257/1/a të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pra operatori ekonomik “Rotonext” duhet të paguajë taksën doganore të papaguar në eksport në shumën totale 4,846 lekë

detyrim TDP dhe dyfishin e detyrimit doganor si penalitet në shumën 9,692 lekë. Shuma totale e detyrimeve 14,538 lekë. Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtrim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verbali i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032734, nr.719 Prot., datë 06/03/2025, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon : *“Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23/01/2025, subjekti “Rotonext” me autorizimin e RPA Nr.16495/1 dt. 20.12.2022 nuk ka mbyllur autorizimin për vlerën e taksës doganore në shumën 4,846 lekë. Taksa doganore e lindur në import është 4,846 lekë, ndërsa në riekспорт të gjitha deklaratat janë të paisura me certifikatë origjine”* Subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcitur dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Rezulton e provuar se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative të kryer me neglizhencë.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”*.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : *Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28; Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;*

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.9590, dt. 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtarë”, Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “ROTONEXT” sh.p.k me NUIS M26901203C, me seli në Vlorë, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 4,846 (Katërmijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.

- Subjekti “ROTONEXT” sh.p.k me NUIS M26901203C, me seli në Vlorë, të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 9,692 (Nëntëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjet e dy) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “ROTONEXT” sh.p.k me NUIS M26901203C, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR
Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 720/2 Prot.

Vlorë, më 25/03/2025

V E N D I M N r . 3 7

Sot, më datë 25/03/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “**Weldings**” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë (Novoselë, Rruga Nacionale Vlorë - Fier km.5, Slrofotinë, Zona Kadastrale nr.3467, Nr.pasurie 31/1, Nr.Telefoni 0697501260), me administrator z.Roberto Dario, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032735, nr.720 Prot., datë 06/03/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë “Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjislacionin në fuqi”, për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë “Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë”, protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F është mbajtur konstatimi si vijon : “...3.Operatori ekonomik “weldings” Shpk me NIPT M12403010F, vepron nën : Regjimin e përpunimit aktiv nr. 7115/1 prot., datë 06/01/2022, i autorizuar për prodhimin e “Konstruksione metalike të ndryshme, pjesë të përshtatshme të makinerive të ndërtimit”.

Sistemi i autorizuar: me pezullim; Sasia e vlerësuar: 500 Ton; Vlera e vlerësuar 1,000,000 Euro.

Periudha e vlefshmërisë: 12 muaj; Kufiri kohor për rieksporim: 12 muaj.

Mallrat që do të vendosen nën regjimin doganor janë me kod tarifar si më poshtë;

7308, 7215, 7208-19, 7301, 7312, 7317, 7318, 7415, 7306

Produktet kompensues të përfituara nga përpunimi i lëndëve të para do të jenë sipas kodeve tarifar të mëposhtëm; 7308, 8431

- Në fund të periudhës, situata/bilanci material i autorizimit sipas sistemit oracle/ database kombëtar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Procedura	P. Neto	VI. Fat.	Tax. Dog
a	Import 5	5100	407,233	1,075,256	67,725
b	Export 3	5171	407,233	1,075,257	0
c	Totali (a-b)		0.00	-0.49	67,725.00

Referuar tabelës së mësipërme – bilanci material i autorizimit nuk rezulton i mbyllur për vlerën e taksës doganore në shumën 67,725 lekë.

Në analizë të deklaratave të eksportit, konstatohet se, të gjitha eksportet janë të pajisur me certifikatë origjine shqiptare, si rrejdhoj bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Doganor të RSH, në të cilin parashikohet shprehimisht: “Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat joorigjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territoreve ose grup-vendeve ose territoreve të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore të rieksporit për këto mallra”, si dhe pikën 14 të udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të RPA” dhe pikën XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës” të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të RPA”, mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e përpunuara të cilat kanë përfituar origjinë preferenciale shqiptare duhet t'i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se operatori ekonomik ka konsumuar kundërvajtje administrative të parashikuara nga nenet 250/1/a dhe 252/c të Kodit Doganor dhe duhet të penalizohet në mbështetje të nenit 257/1/a të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pra operatori ekonomik “weldings” duhet të paguajë taksën doganore të papaguar në eksport

në shumën totale 67,725 lekë detyrim TDP dhe dyfishin e detyrimit doganor si penalitet në shumën 135,450 lekë. Shuma totale e detyrimeve 203,175 lekë.

Nga auditimi i deklaratave të eksportit, konstatohet se, të gjitha eksportet janë të pajisur me certifikatë origjine shqiptare, si rrejdhoj bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Doganor të RSH, në të cilin parashikohet shprehimisht: “Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat joorigjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territoreve ose grup-vendeve ose territoreve të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore të riekportit për këto mallra”, si dhe pikën 14 të udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të RPA” dhe pikën XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës” të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të RPA”, mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e përpunuara të cilat kanë përfituar origjinë preferenciale shqiptare duhet t'i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale.

Për konstatimin e lartcitur, Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, e ka njoftuar subjektin mbi fillimin e procedurës administrative, me anë të shkresës nr.3776 Prot., datë 19/12/2024, me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën i ka kërkuar subjektit paraqitjen e të gjithë dokumentacionit, informacionet përkatëse, provat, mendimet, shpjegimet e mundshme, kundërshtimet, propozimet etj, të cilat hedhin dritë mbi veprimet e kryera nga ana Juaj për regjimin doganor të lartpërmendur.

Rezulton se nga ana e avokatit të subjektit është administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë shkresa me nr.3467/1 Prot., datë 20.01.2025, me lëndë “Kundërshtim për konstatimet e auditimit mbi detyrimet dhe penalitetet doganore”, ku midis të tjerave ka parashtruar propozimet si vijon :

- Rishikimi i vendimit për vendosjen e penaliteteve dhe eliminimi i gjobës së dyfishit të detyrimit doganor. Penalitetet duhet të jenë propocionale dhe të bazuara në një analizë të plotë të fakteve, duke pasur parasysh mungesën e qëllimësisë në shkeljet e pretenduara.
- Rishikimi i shumës së detyrimeve të pretenduara, duke marrë në konsideratë dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë, i cili vërteton shlyerjen korrekte dhe në kohë të të gjitha detyrimeve të kërkuara deri më sot.

- Një vendimmarrje të drejtë dhe proporcionale, që reflekton rrethanat lehtësuese dhe historikun e respektimit të regullave nga shoqëria jonë. ...

Më tej, nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, protokolluar me Tonën me nr.1666/7, datë 24/01/2025, me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032735, nr.720 Prot., datë 06/03/2025, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon : “Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23/01/2025, subjekti “Weldings” në Autorizimin e RPA Nr.7115/1 dt.06.01.2022 nuk ka mbyllur autorizimin për vlerën e taksës doganore në shumën 67,725 lekë. Taksa doganore e lindur në import është 67,725 lekë, ndërsa në eksport deklaratat janë të paisura me certifikatë origjine shqiptare”.

Subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcitur, pasi është njoftuar me anë të korepondencës elektronike më datë 12/03/2025, si dhe me anë të shkresës nr.808/1 Prot., datë 13/03/2025, me lëndë “Njoftim i process verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative” dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Rezulton e provuar se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative të kryer me neglizhencë.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;* Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : 1. *Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive,*

proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.9590, dt. 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtarë”, Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **67,725** (Gjashtëdhjet e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë, të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **135,450** (Njëqind e tridhjet e pesë mijë e katërqind e pesëdhjet e dy) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, i lejohej të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penaltetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 808/2 Prot.

Vlorë, më 25/03/2025

V E N D I M N r. 38

Sot, më datë 25/03/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “**Weldings**” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë (Novoselë, Rruga Nacionale Vlorë - Fier km.5, Slrofotinë, Zona Kadastrale nr.3467, Nr.pasurie 31/1, Nr.Telefoni 0697501260), me administrator z.Roberto Dario, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032742, nr.808 Prot., datë 12/03/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë “Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjislacionin në fuqi”, për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë “Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë”, protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F është mbajtur konstatimi si vijon : “...3.Operatori ekonomik “weldings” Shpk me NIPT M12403010F, vepron nën : Regjimin e përpunimit aktiv nr. 17157/1 prot., datë 29.12.2022, i autorizuar për prodhimin e “Konstruksione metalike të ndryshme, pjesë të përshtatshme të makinerive të ndërtimit”.

Sistemi i autorizuar: me pezullim; Sasia e vlerësuar: 1,150 Ton; Vlera e vlerësuar 2,540,000 Euro.

Periudha e vlefshmërisë: 12 muaj; Kufiri kohor për rieksporim: 12 muaj.

Mallrat që do të vendosen nën regjimin doganor janë me kod tarifar si mëposhtë;

7308, 7215, 7208, 7301, 7312, 7317-18, 7415, 7306

Produktet kompensues të përfituara nga përpunimi i lëndëve të para do të jenë sipas kodeve tarifar të mëposhtëm; 7308, 8431

• Në fund të periudhës, situata/bilanci material i autorizimit sipas sistemit oracle/ database kombëtar paraqitet si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi	Procedura	P. Neto	VI. Fat.	Tax. Dog
a	Import 5	5100	400,833	1,226,467	32,207
b	Export 3	5171	400,833	1,226,466	0
c	Totali (a-b)		0.00	0.40	32,207.00

Referuar tabelës së mësipërme – bilanci material i autorizimit nuk rezulton i mbyllur për vlerën e taksës doganore në shumën 32,207 lekë.

Në analizë të deklaratave të eksportit, konstatohet se, të gjitha eksportet janë të pajisur me certifikatë origjine shqiptare, si rrejdhoj bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Doganor të RSH, në të cilin parashikohet shprehimisht: “Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat joorigjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territoreve ose grup-vendeve ose territoreve të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore të rieksporit për këto mallra”, si dhe pikën 14 të udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të RPA” dhe pikën XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës” të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të RPA”, mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e përpunuara të cilat kanë përfituar origjinë preferenciale shqiptare duhet t’i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se operatori ekonomik ka konsumuar kundërvajtje administrative të parashikuara nga nenet 250/1/a dhe 252/c të Kodit Doganor dhe duhet të penalizohet në mbështetje të nenit 257/1/a të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pra operatori ekonomik “Weldings” duhet të paguajë taksën doganore të papaguar në

eksport në shumën totale 32,207 lekë detyrim TDP dhe dyfishin e detyrimit doganor si penalitet në shumën 64,414 lekë. Shuma totale e detyrimeve 96,621 lekë.

Nga auditimi i deklaratave të eksportit, konstatohet se, të gjitha eksportet janë të pajisur me certifikatë origjine shqiptare, si rrejdhoj bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Doganor të RSH, në të cilin parashikohet shprehimisht: “Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat joorigjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territoreve ose grup-vendeve ose territoreve të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimin të deklaratës doganore të rieksporimit për këto mallra”, si dhe pikën 14 të udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të RPA” dhe pikën XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës” të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të RPA”, mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e përpunuara të cilat kanë përfituar origjinë preferenciale shqiptare duhet t'i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se operatori ekonomik ka konsumuar kundërvajtje administrative të parashikuar nga nenet 250/1/a dhe 252/c të Kodit Doganor dhe duhet të penalizohet në mbështetje të nenit 257/1/a të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pra operatori ekonomik “Weldings” duhet të paguajë taksën doganore të papaguar në eksport në shumën totale 32,207 lekë detyrim TDP dhe dyfishin e detyrimit doganor si penalitet në shumën 64,414. Shuma totale e detyrimeve 96,621 lekë.

Për konstatimin e lartcitur, Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, e ka njoftuar subjektin mbi fillimin e procedurës administrative, me shkresën nr.3776 Prot., date 19/12/2024.

Rezulton se nga ana e avokatit të subjektit është administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë shkresa me nr.3467/1 Prot., datë 20.01.2025, me lëndë “Kundërshtim për konstatimet e auditimit mbi detyrimet dhe penalitetet doganore”, ku midis të tjerave ka parashtruar propozimet si vijon :

- *Rishikimi i vendimit për vendosjen e penaliteteve dhe eliminimi i gjobës së dyfishit të detyrimit doganor. Penalitetet duhet të jenë propocionale dhe të bazuara në një analizë të plotë të fakteve, duke pasur parasysh mungesën e qëllimësisë në shkeljet e pretenduara.*

- *Rishikimi i shumës së detyrimeve të pretenduara, duke marrë në konsideratë dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë, i cili vërteton shlyerjen korrekte dhe në kohë të të gjitha detyrimeve të kërkuara deri më sot.*
- *Një vendimmarrje të drejtë dhe proporcionale, që reflekton rrethanat lehtësuese dhe historikun e respektimit të regullave nga shoqëria jonë. ...*

Më tej, nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, protokolluar me Tonën me nr.1666/7, datë 24/01/2025, me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtime të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verbal i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032742, nr.808 Prot., datë 12/03/2025, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon : “Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23/01/2025, subjekti “Weldings” në Autorizimin e RPA Nr.17157/1 dt.29.12.2022 nuk ka mbyllur autorizimin për vlerën e taksës doganore në shumën 32,207 lekë. Taksa doganore e lindur në import është 32,207 lekë, ndërsa në eksport deklaratat janë të paisura me certifikatë origjine shqiptare”. Subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcitur, pasi është njoftuar me anë të korepondencës elektronike më datë 12/03/2025, si dhe me anë të shkresës nr.808/1 Prot., datë 13/03/2025, me lëndë “Njoftim i process verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative” dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Rezulton e provuar se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative të kryer me neglizhencë.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve

që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28; Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;


Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.9590, dt. 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtarë”, Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **32,207** (Tridhjet e dymijë e dyqind e shtatë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë, të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **64,414** (Gjashtëdhjet e katërmijë e katërqind e katërmbëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.908/2 Prot.

Vlorë, më 03/04/2025

VENDIM Nr.44

Sot, më datë 03/04/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, me seli në Vlorë (Lagjja “Bashkimi”, Rruga “Sado Koshena”, Nr.10; Nr. Tel : 0692024399), me administrator z.Illir Dervishi, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032744, Nr.908 Prot., datë 25/03/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, protokolluar me Tonën me nr.1666/7, datë 24/01/2025, me lëndë “*Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë*”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Nga kontrolli dhe verifikimi i kryer, rezulton se subjekti “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, ka përfituar nga ana e Degës së Doganës Vlorë autorizimin për regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet doganore Nr.1544/1 prot., datë 11.05.2020, me afat kohor vlefshmërie 12 muaj, mbi bazën e të cilit, nga ana e subjektit është përpunuar deklarata doganore IM.5 R 3656, datë 12/05/2020, ku ka deklaruar artikullin “fustela 138 copë”, klasifikuar në kodin tarifor *84803090*. Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se autorizimi i regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet doganore nr. P20200511/1544/1, rezulton i pa mbyllur, brenda afatit të autorizuar 12 mujor.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shqyrtim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032744, Nr.908 Prot., datë 25/03/2025, ku në pjesën

përshkruese është parashtruar si vijon : “Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 prot., dt. 23/01/2025, subjekti “Simak Shoes” i pajisur me autorizimin e RLP Nr.1544/1 dt 11-05-2020, nuk i ka dhënë destinacion doganor mallrave të importuara Brenda afateve kohore të përcaktuar në autorizim. Nga kontrolli fizik i ushtruar në ambientet e operatorit ekonomik rezulton se fustelat gjendeshin në ambientet e subjektit”. Rezulton e provuar se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative të kryer me neglizhencë. Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Ndërsa në nenin 257, 1/b kemi : 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke garantuar paraprakisht 100% penaltitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj

